

PJESA II**Albert KAMY****I huaji (fragment)**

Ky fragment është shkëputur nga pjesa e dytë e veprës së Kamysë “ I huaji”. Është momenti kur Merso, personazhi kryesor, pasi ka marrë dënimin për krimin e kryer, vizitohet në qelinë e tij nga prifti, i cili kërkon pendesën e Mersosë.

Prifti më thoshte me siguri se kërkesa ime për falje, mund të pranohej, por unë do të mbaja me vete peshën e një krimi, nga i cili duhet të çlirohesh. Sipas tij drejtësia e njerëzve nuk ishte asgjë, ndërsa ajo e Zotit ishte gjithçka. Vura në dukje se më kishte dënuar ajo e para. Ai m'u përgjigj se ajo nuk e kishte larë mëkatin tim. I thashë se nuk e dija se çfarë është një mëkat. Më kishin mësuar të kuptoja se isha vetëm një fajtor. Isha fajtor dhe për këtë po paguaja, nuk mund të më kërkonin asgjë tjetër. Në këtë moment, ai u ngrit përsëri dhe mendova se nëse donte të lëvizte në këtë qeli kaq të ngushtë nuk do të kishte mundësi. Duhej ose të ulej ose të ngrihej.

I kisha sytë të fiksuar përdhe. Bëri një hap drejt meje dhe ndaloi, sikur të mos guxonte të bënte më përpara. Vështronte qiellin nëpërmjet hekurave të dritares.

“- Gaboheni, biri im, - më tha ai, - mund t'ju kërkojnë më shumë. Ndoshta do t'ju kërkojnë...

- Çfarë mund të më kërkojnë?

- Mund t'ju kërkojnë që të shihni.

- Çfarë?

Prifti vështroi përreth tij dhe u përgjigj papritur me një zë të lodhur: gjithë këta gurë djersijnë dhembje, e di mirë. Gjithmonë i kam shikuar me ankth. Por, në thellësi të zemrës, e di mirë që më mjeranët nga ju kanë parë që nga errësira e tyre ka dalë një fytyrë e shenjtë. Ju kërkohet që të shihni pikërisht këtë fytyrë.”

Sikur u gjallërova pak. I thashë se kishte muaj që shikoja këto mure të trashë. Nuk kishte asgjë dhe asnjë njeri që të mund ta njihja më mirë se këto mure. Ndoshta para disa kohësh, kisha kërkuar dhe unë të gjeja aty një fytyrë. Por kjo fytyrë kishte ngjyrën e diellit dhe flakën e dëshirës: ishte fytyra e Marisë. E kisha kërkuar më kot aty brenda. Tashmë çdo gjë kishte marrë fund. Gjithsesi, në asnjë rast nuk kisha parë të shfaqej ndonjë gjë nga kjo djersë që lëshonin gurët.

Sapo ai iku, rigjeta përsëri qetësinë time. Isha i dërmuar dhe u hodha mbi dyshekun tim. Mendoj se më kishte zënë gjumi pasi u zgjova dhe pashë yjet sipër kokës. Zhurmat e fshatit vinin deri tek unë. Aromat e natës, të tokës dhe të kripës freskonin tëmthas e mi. Paqja e mrekullueshme e kësaj vere të përgjumur futej tek unë si një vërshim i papërmbajtshëm. Në këtë moment që përkonte dhe me fillimin e agimit të ditës së re, ulërinë sirenat. Ato më njoftonin nisjen për në një botë tjetër, për të cilën nuk isha më indiferent. Për herë të parë, që prej shumë kohësh mendova për mamanë. E kuptova se përse në fund të një jete ajo kishte gjetur “një të fejuar”, se përse ajo kishte filluar të luante për të rifilluar edhe njëherë nga e para. Edhe atje, atje, përreth kësaj azileje ku shuheshin jetë, mbrëmja ngjante me një pushim melankolik. Kaq pranë vdekjes, mamaja duhet të jetë ndjerë e lirë dhe e gatshme për të rijetuar edhe njëherë gjithçka. Asnjë, por asnjë nuk kishte të drejtë të qante mbi të. Dhe unë gjithashtu u ndjeva gati për të jetuar përsëri. Sikur gjithë ky zemërim më kishte pastruar nga e keqja, më kishte boshatisur nga shpresa, përpara kësaj nate të mbushur me shenja dhe yje po i hapsha për herë të parë indiferencës së butë të kësaj bote.

Për pyetjet 13-18 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

13. Jeta e personazhit kryesor Merso paraqitet si një lojë e pamëshirshme midis: **1 pikë**

- A) kujtesës dhe harresës.
- B) së bukurës dhe së shëmtuarës.
- C) realitetit dhe ëndrrës.
- D) absurdit dhe njeriut.

14. Cila konsiderohet pika më e fortë e romanit dhe që shërben si mjet komunikimi me lexuesin? **1 pikë**

- A) Komentet e zgjatura.
- B) Figuracioni i pasur.
- C) Rrëfimi në vetën e parë.
- D) Personazhet e shumta.

15. Shprehja “një të fejuar” është futur në thonjëza: **1 pikë**

- A) për të dhënë dëshirën e individit për të rifilluar nga e para.
- B) për të dhënë kontrastin midis burrit dhe gruas.
- C) për të treguar vlerën e një veprimi si fejesa.
- D) për të thënë thjesht se çfarë kishte bërë mamaja.

16. Ngjarjet në vepër rrjedhin fatalisht sikurse ndodh në veprat e: **1 pikë**

- A) Rilindjes
- B) Antikitetit
- C) Realizmit
- D) Romantizmit

17. Fjala *i huaj* është e lidhur në këtë vepër me një njeri, i cili: **1 pikë**

- A) vjen nga një vend i largët dhe i huaj.
- B) flet një gjuhë të huaj dhe të padëgjuar më parë.
- C) ndryshon shpesh mendim, në marrëdhënie me veten.
- D) ndihet vazhdimisht i huaj në mjedisin ku jeton.

18. Ligjërata e zhdrejtë në paragrafin e parë jep: **1 pikë**

- A) tiparin e një stili të ngjeshur dhe të veprimit që ndodh shpejt.
- B) indiferencën e priftit ndaj Mersoit.
- C) marrëdhënien e personazhit me natyrën.
- D) dëshirën e Mersoit për të qenë i pushtetshëm.

19. Në secilin nga paragrafët kemi një gjendje të personazhit kryesor. Jepni kuptimin e çdo paragrafi me një fjali të thjeshtë. **4 pikë**

Fjalja I: _____ Fjalja II: _____

Fjalja III: _____ Fjalja IV: _____

20. Sikundër në të gjithë veprën edhe këtu dielli kryen një funksion të veçantë. Çfarë dëshire i zgjon imazhi i tij Mersosë? **1 pikë**
-
21. Nga e kupton Merso që kishte ardhur momenti për t'u nisur në botën tjetër? Cili është sinjali që e njofton atë në paragrafin e fundit? Shpjegoni pse ai nuk është më indiferent ndaj jetës. Gjeni të paktën dy fjalë kyçe për ta ilustruar këtë.
- a) sinjali: _____ **1 pikë**
- b) shpjegimi: _____ **1 pikë**
- _____
- c) fjalët kyçe: _____ **1 pikë**
22. Stili i Kamysë shfaq disa tipare. Gjeni një tipar të tij të përdorur në këtë fragment. Shpjegoni përdorimin duke e ilustruar me shembull.
- a) tipari i zgjedhur: _____ **1 pikë**
- b) shpjegimi: _____ **1 pikë**
- _____
- c) shembulli: _____ **1 pikë**
23. Merso po shkon drejt ekzekutimit. Pse ai nuk mund ta shmangë atë? Çfarë ndjesie ju krijon kjo gjë? Cilët personazhe të veprës kanë më përpara se Merso pikëtakimi me vdekjen?
- a) pse nuk shmanget: _____ **1 pikë**
- _____
- b) ndjesia: _____ **1 pikë**
- c) personazhet: _____ **1 pikë**
24. Në paragrafin e parë lexuesi ndeshet me dy lloj drejtësish. Identifikoni ato. Në ç' marrëdhënie ndodhen dy drejtësitë dhe cili është mjeti gjuhësor që e realizon këtë?
- a) dy drejtësitë: _____ **1 pikë**
- b) marrëdhënia midis tyre: _____ **1 pikë**
- c) mjeti gjuhësor: _____ **1 pikë**
25. Kamy shprehet: *“te njeriu ka më shumë gjëra për t'u admiruar sesa për t'u përbuzur”*. Çfarë tregon kjo? Argumentoni nëse e gjejmë të shprehur këtë mendim te Merso? **3 pikë**
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____